



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:111091

Datë: 25.07.2022

Numri i dokumentit: 03261024

P.Nr.330/2022

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me zyrtare ligjore Atdhetare Bashota Krasniqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit B.S., për shkak të veprës penale: Vjedhje, nga neni 313, par.2, të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.Nr, 870/2021 (2021:0030802), të datës 31.05.2022, duke vendosur sipas kërkesës për shqiptimin e urdhrimit ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 25.07.2022, nxjerr këtë:

### A K T G J Y K I M

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.Nr, 870/2021 (2021:0030802), të datës 31.05.2022, kjo gjykatë jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

B.S., me nofkën “G.”, nga i ati Q., e ëma R., e vajzërisë Z., “data e lindjes”..., në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, i papunë, nuk e ka vijuar shkollimin, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 14.04.2022, rreth orës 23:00 h, në Mitrovicë, në ndërtesën kolektive “A...”, me qëllim që vetes ose personit tjetër ti sigurojë dobi pasurore, në korridorin e ndërtesës, nga kutia postare ka tjetërsuar 10 €, e cila ndërtesë ka qenë nën mbikëqyrjen e kamerave,

Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhje, nga neni 313, par.2, të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 1, 3, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, e 313, par. 2, të KPRK-së, si dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, 495, 496, të KPP-së i:

## SHQIPTON

1. Dënim me gjobë në shumë prej 100 € (njëqind euro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që të filloj ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I njëjti, dënimin e shqiptuar mund ta paguaj me tre (3) këste të barabarta, më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43, të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë, apo me pëlqimin e tij dënimi me gjobë mund t'i zëvendësohet edhe me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.
2. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale, dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 10€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Kërkesë pasurore – juridike nuk pati.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.Nr.870/2021 (2021:0030802), të datës 31.05.2022, kundër të pandehurit: B.S., për shkak të veprës penale: Vjedhje, nga neni 313, par.2, të KPRK-së, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri, vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 493, i KPP-së, që të pranohet kërkesa për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe në përputhje me nenin 495, të KPP-së të jepet aktgjykimi pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë fajësinë e të pandehurit se e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë dhe atë: Raporti i policit, i datës 15.04.2022; Deklarata mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit B1.S1., e datës 15.04.2022; Deklarata mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit, e datës 26.04.2022; Fotografitë e vendit të ngjarjes, gjithsejtë 2 fotografi dhe Evidenca Penale e personit; Të gjitha keto janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Sipas KPRK-së, për veprën penale: Vjedhje, nga neni 313, par.2, të KPRK-së, është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Gjykata në përputhje me nenin 69, të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësojë të gjitha rrethanat në matjen e dënimit, ashtu që gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet

qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38, të KPRK-së, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i pandehuri do të përmbahet nga veprime të paligjshme, do të ketë kujdes të shtuar sa i përket pasurisë e sidomos kur është fjala për pasurinë e huaj, e sidomos faktin se shërbimet duhet shfrytëzuar në mënyrën dhe formën e caktuar me rregullat në fuqi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morë në bazë të nenit 450, par.2, pika 2.6 dhe 453, par.1, të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39, par.3, të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesë pasurore – juridike nuk pati, ngase në aktakuzë nuk kishte palë të dëmtuar të propozuar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.Nr.330/2022, datë 25.07.2022**  
**2022:111091, 25.07.2022**

**Gjyqtari**

---

**Rrahman Beqiri**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi pala ka të drejtë kundërshtimi, në afat prej 8 (tetë) ditëve, nga dita e pranimit. Kundërshtimi i parashtrohet kësaj Gjykate.